



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:031470
Datë: 06.11.2024
Numri i dokumentit: 06414063

C.nr.253/21

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Agron Karatash, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.M. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. A.A. nga Prizreni, kundër të paditurës Spitali i Përgjithshëm “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson L.M. nga Prizreni me objekt kontesti pasurim i pabazë, vlera e kontestit 833.30 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datë 06.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit N.M. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të *“OBLIGOHET e paditura Spitali i Përgjithshëm “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren, që në emër të pasurimit të pa bazë t’ia kompensojë shumën prej 833.30 euro, si dhe OBLIGOHET i padituri Spital i Përgjithshëm “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren që të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm”* si e **pa bazuar**.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi N.M. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij av. A.A. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 19.02.2021, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Spitali i Përgjithshëm “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren, me objekt të kontestit kthimin e borxhit, vlera e kontestit 833.30 euro. Në referatin e padisë i autorizuari i paditësit ka theksuar se paditësi N.M. ka qenë në marrëdhënie pune në Spitalin e Përgjithshëm në Prizren, në cilësinë e zyrtarit të financave. Me datë 20.07.2017, subjekti ekonomik N.T.SH. “Rejhan-Servis” me seli në Prizren, ka furnizuar me material teknik këtu të paditurin Spitalin e Përgjithshëm në vlerë prej 833.30 euro, në bazë të profaturave të lëshuara nga subjekti i lartpërmendur. Meqenëse këto profatura, i padituri Spitali i Përgjithshëm në Prizren i ka pranuar dhe nuk e ka përmbushur detyrimin ndaj furnizuesit N.T.SH. “Rejhan-Servis”, jam detyruar që këtë detyrim në shumë prej 833.30 euro, ta paguaj unë, në bazë të urdhërpagesave të lëshuara nga subjekti ekonomik i lartpërmendur, andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e tij.

I autorizuari i paditësit në procesverbalin e seancës përgaditore ka bërë ndryshimin e padisë sa i përket objektit të kontestit përkatësisht që si objekt kontesti në këtë çështje juridiko-civile do të jetë pasurimi i pabazë.

I autorizuari i të paditurës nuk ka paraqitur përgjigjen në padi.

I autorizuari i paditësit av. A.A. në seancën përgaditore edhe përgjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi nga të dhënat që janë cekur në padi dhe kërkesës së tij, duke shtuar se paditësi N.M. ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura në cilësi të zyrtarit certifikues, bazuar në dispozitat e nenit 57 të Ligjit për Prokurim Publik nuk ka qenë e nevojshme shpallja e tenderit publik kur bëhet fjalë për furnizim apo punë tjetër deri në lartësi prej 1000 euro. Paditësi konform porosive nga personi zyrtar i të paditurës, instaluesin e ujit e ka njoftuar për shkak të rrjedhave të ujit se ka nevojë për material me të cilin do të riparonte dëmet. Paditësi bazuar në këtë angazhon subjektin Rejhan Servis me seli në Prizren që të furnizoj të paditurën me materialin e përshtuar si në provat e bashkangjitura padisë mirëpo e paditura edhe përkundër pranimit të materialit nuk e ka kompensuar këtë. Më tej ka deklaruar se paditësi duke qenë nën presion nga subjekti ekonomik i lartcekur dhe duke marrë parasysh faktin se lartësia e kompensimit ishte më e ulët se 1000 euro, personalisht ia paguan materialin e dorëzuar tek e paditura, paditësi ka parashtruar dhe dorëzuar kërkesë tek e paditura me qëllim që ta kompensoj lidhur me materialin e pranuar mirëpo asnjëherë nuk i është përgjigjur kërkesës së tij. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi është vërtetuar kërkesa e palës paditëse nga administrimi dhe shqyrtimi i provave dhe atë nga profakturat të cilat janë të pranuar në mënyrë të rregullt është vërtetuar lloji i materialit dhe sasia e tij e dorëzuar kurse nga urdhërpagesat është vërtetuar se këtu paditësi ka kryer pagesën e detyrimit. Në këtë çështje kontestimore nuk kemi parashkrim të kërkesës siç pretendon e paditura për faktin se kjo çështje ka qenë kërkesë komerciale dhe jo nga lëmia e punës. Bazuar në dispozitat e nenit 194 të LMD-së, konsiderojnë se këtu e paditura është pasuar pabazë ligjore në dëm të tjetrit andej edhe duhet të kompensoj atë. Bazuar në të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që të aprovoj në tërësi si të bazuar padinë dhe kërkesës e saj dhe të obligoj të paditurën që të kompensoj këtu paditësin në shumën prej 833.30 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro, për përfaqësim në dy seanca nga 135 euro (270 euro) dhe për taksën gjyqësore shumën prej 20 euro, apo shumën e përgjithshme prej 394 euro.

I autorizuari i të paditurës L.M. në seancën përgaditore edhe përgjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se nuk e konteston faktin se i padituri ka qenë në marrëdhënie pune në Spitalin e Prizrenit në cilësinë e zyrtarit certifikues, mirëpo për pagesën në fjalë bazuar sipas paditësit, i njëjti nuk ka pasur autorizim dhe as nuk ka qenë kompetencë e zyrtarit certifikues që të njëjtën ta kryej në mënyrë private, kjo e gjitha pasi që të njëjtën rast mos pagese ka mundur ta ushtroj vet operatori ekonomik Servis. Gjithashtu bazuar edhe në kërkesëpadinë e parashtruar nga ana e paditësit me datë 19.02.2021, ndërsa pagesat e pretenduara nga ana e profaturave të paraqitura në padi kanë datën 20.07.2017, andaj duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës tek afati i parashkrimit, ka kërkuar nga gjykata që kjo kërkesëpadi të konsiderohet e pabazë dhe si e tillë të hedhet poshtë. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se qëndrojnë prapa deklarimeve paraprake se në lidhje me kërkesëpadinë e paditësit nuk ekzistojnë argumente të cilat kanë derivuar gjatë kohës që i njëjti deklaroi se ka kryer pagesën, lidhur më këtë bazuar edhe në deklarimet e paditësit se i njëjti nuk ka pasur autorizim zyrtar për kryerjen e kësaj pagese si dhe deklarimin e tij se ka qenë i urdhëruar nga ana e drejtorit general edhe pse i njëjti nuk deklaroi

se ka njoftuar drejtorin që kërkesa e tij për urdhër për të kryer këtë pagesë është në kundërshtim me detyrat e tij si zyrtar çertifikues. Andaj ka kërkuar nga gjykata që këtë kërkesëpadi ta refuzoj si të pabazuar pasi që nga faktet e tregura nuk del themelësia e kërkesëpadisë. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata ka administruar provat si në vijim: dëgjimin e paditësit N.M. në cilësi të palës në shqyrtimin e datës 16.09.2024, profaturën me nr. 001/2017, e datës 20.07.2017, profaturën me nr. 002/2017, e datës 20.07.2017, profaturën me nr. 003/2017, e datës 20.07.2017, urdhërpagesën me nr. 01/2018, e datës 01.06.2018, urdhërpagesën me nr. 02./2018 e datës 20.06.2018, kërkesën për kompensimin e borxhit me nr. 3/111, e datës 10.07.2020.

Gjykata pas vlerësimit të theksimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e **pa bazuar**.

Gjykata në shqyrtimin kryesor të datës 16.09.2024, e ka bërë dëgjimin e paditësit N.M. në cilësi të palës i cili ka deklaruar se gjatë periudhës 2015 deri në dalje në pension ka qenë zyrtarë certifikues financiar në Spitalin e Prizrenit. Gjatë funksionimit në këtë detyrë kam qenë i autorizuar të ekzaminoj të gjitha pagesat të cilat kanë qenë të lidhura me furnizimin dhe shpenzimet e tjera të spitalit, pa ekzaminimin tim dhe 4 personave të tjerë nuk ka qenë e mundur që të ekzekutohet pagesa. Më tej ka deklaruar se këto furnizimet kanë ndodhur në periudhat kur tenderi ka qenë i tejkaluar, apo jashtë periudhës tenderuese, mirëpo në anën tjetër për shkak se spitali është i vjetër dhe ka mbi 1000 kroje dhe ka pasur nevojë pikërisht në kohën vakante për disa nevoja sanitare, ku për këtë mua më ka njoftuar mjeshtri i cili merret me mirëmbajtjen e gjësendeve sanitare. Me të marrë kërkesën nga mjeshtri, duke pasur parasysh se unë si zyrtar financiar sipas ligjit kam të drejtë që deri në vlerë 1000 euro, pa ndonjë procedurë tenderuese të furnizoj spitalin unë kam ndërmarrë veprime lidhur më këtë dhe jam drejtuar NTSH “..... Servis” në Prizren, duke i thënë të na del në ndihmë për nevojat e spitalit dhe deri në 1000 euro të na furnizoj me sanitari, ia kam tërhequr vërejtjen se nuk guxon të tejkalon vlerën prej 1000 euro dhe më kujtohet se një ditë më kontaktoj duke më thënë se vlera prej 1000 euro tani më është tejkaluar nga ana e tani të ndjerit J. (mjeshër për mirëmbajtje) dhe unë pas kësaj kam thënë se duhet të ndërprehet dhe të mos furnizoj apo të jep produkte sanitare sepse më tepër se 1000 euro unë nuk kam të drejtë të ekzekutoj. Më pas është lajmëruar Rejhani duke kërkuar që të kryhet pagesa sa i përket furnizimeve me material sanitar ku i njëjti ka qenë i shqetësuar sepse spitali ia ka refuzuar këtë kërkesë konkretisht zyra për financa ku pas 2-3 tentimeve kanë thënë se nuk ke nevojë të na sjellësh këto fatura sepse nuk jeni konkurrues-tenderues i rregullt, më të informuar lidhur më këtë akt unë i kam thënë se nuk ka nevojë të shqetësohet sepse për të gjitha këto pagesa nëse paraqitet nevoja unë do t’i realizoj vet nga të ardhurat e mia personale dhe të njëjtën gjë e kam bërë, paguar në dy këste. Po ashtu ka deklaruar se nuk kam pasur të drejtë jo vetëm unë po as edhe 4 zyrtarët e tjerë në mënyrë individuale të japim leje për pagesë, por e theksoj se unë kam marrë urdhër verbal prej drejtorit gjeneral që çkado që ka nevojë spitali unë të ndërmarrë veprimet e nevojshme që për shkak të procedurave spitali të mos mbetet keq, kjo bëhet fjalë në rastet e jashtëzakonshme. Në fund ka deklaruar se unë fillimisht i jam drejtuar zyrtarit kryesor financiar dhe ai ka refuzuar të kryej këtë pagesë duke u përgjigjur se nuk është tenderues i rregullt që ka marrë pjesë në procedurat e tenderimit dhe një pagesë

e tillë nuk mund të realizohet nga kjo zyre, më të marrë këtë përgjigje unë nuk kam pasur rrugë tjetër vetëm se t'i kryej pagesat nga të ardhurat e mia personale.

Nga shiqimi i profaturave me nr. 001/2017, nr. 002/2017, nr. 003/2017, të datës 20.07.2017, gjykata ka vërtetuar faktin e dorëzimit të materialeve nga shitësi N.T.S.H. “.....-Servis” tek blerësi Spitali Rajonal “Prim. Dr. Daut Mustafa”, por që nuk dihet se nga kush janë pranuar.

Nga shiqimi i urdhërpagesës me nr. 01/2018, e datës 01.06.2018 dhe urdhërpagesës me nr. 02/2018, e datës 20.06.2018, gjykata ka vërtetuar faktin e e pagesave të kryera në emër të profaturave me nr. 001/2017, nr. 002/2017, nr. 003/2017, të datës 20.07.2017.

Nga shiqimi i kërkesës për kompensimin e borxhit me nr. 3/111, e datës 10.07.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se këtu paditësi N.M. i është drejtuar këtu të paditurës Spitali i Përgjithshëm “Prim. Dr. Daut Mustafa” Këshillit drejtues në Prizren me kërkesë për kompensimin e borxhit në shumën prej 833.30 euro.

Baza Ligjore

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-077, Për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), shprehimisht përcaktohet se: “*Secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetrit, është i detyruar të kthejë atë që ka marrë nga tjetri, ose ndryshe të kompensojë vlerën e fitimit të arritur*”. Më tutje, me nenin 194 par. 3 të LMD-së, parashihet që: “*Detyrimi për kthim ose kompensim po ashtu lind edhe nëse një person pranon diçka në lidhje me një bazë që nuk është realizuar ose më pas zhduket*”. Po ashtu me nenin 195 të po këtij ligji parashihet “*Kush kryen pagesën duke ditur se nuk e ka për detyrë ta paguajë nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin, përveç nëse e ka rezervuar të drejtën e kërimit të kthimit, apo në qoftë se e ka paguar për t'iu shmangur dhunës*”. Ndërsa duke u bazuar në nenin 7.1 të LPK-së i cili përcakton se: “*Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*”, lidhur me nenin 319 par.1 të këtij ligji i cili përcakton se “*Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoj faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*” dhe nenin 322.1 të këtij ligji i cili përcakton se “*Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8) nuk mund të konstatoj me siguri një fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës*”.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Për gjykatën, por edhe për palët ndërgjyqës nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune në Spitalin e Prizrenit në cilësinë e zyrtarit certifikues. Kontestuese ishte nëse pala paditëse ka pasur autorizim dhe kompetencë që si zyrtar certifikues në mënyrë private të paguajë operatorin ekonomik “..... Servis” në shumën prej 833.30 euro.

Në bazë të provave të administruara në këtë procedurë, gjykata ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar edhe se e njëjta duhet refuzohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, kjo për faktin se në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar është provuar se paditësi si zyrtar certifikues nuk ka pasur kompetencë e as autorizim që në mënyrë individuale të kryej pagesa në emër të të paditurës. Se paditësi nuk ka pasur autorizim të kryej pagesa në emër të të paditurës gjykata e ka vërtetuar edhe nga vet deklarata e paditësit i cili në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se nuk kam pasur të drejtë jo vetëm unë por as edhe 4 zyrtarët e tjerë në mënyrë

individuale të japim leje për pagesë. Duke u bazuar në nenin 195 të LMD –së rrjedh se pagesa e bërë ndonjë personi, në kuptim të dhënies ose të sjelljes së çfarëdo dobie atij, duke ditur se atë që po e bën dhe po e jep nuk e ka borxh, nuk përfaqëson pagesë të asaj që e ka borxh dhe në këtë mënyrë, as pasurim pa bazë, personi që e ka bërë pagesën në këtë mënyrë, nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin e asaj pagese Po ashtu edhe nga shiqimi i profaturave të cilat janë administruar në këtë çështje kontestimore, gjykata nuk ka mundur të vërtetoj se nga kush janë pranuar këto profatura në emër të të paditurës. Andaj duke u bazuar edhe në nenin 322 paragrafi 2 të LPK-së në të cilin shprehimisht parashihet se *“Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”* Përfundimisht, gjykata vlerëson se barra e të provuarit mbi çështjen e vërtetimit të pasurimit të pabazë i bie palës paditëse dhe se për faktet të cilat i ka parashtruar duhet të ofrojë edhe prova relevante për vërtetimin e fakteve të pretenduara, andaj pretendimet e paditësit në mungesë të provave mbeten vetëm supozime të pa vërtetuara.

Ndërsa sa i përket pretendimeve të palës së paditur se kërkesa e paditësit është parashkruar gjykata këto pretendime i gjeti si të pa bazuara për faktin se nga urdhërpagesat shihet se pagesat janë bërë me datë 01.06.2018 dhe 20.06.2018, ndërsa padia është parashtruar me datë 19.02.2021, pra që nga krijimi i raportit juridiko-civil e deri në ditën e paraqitjes së padisë kanë kaluar më pak se 3 vite, ndërsa te kontestet e pasurimit të pa bazë vlen afati i përgjithshëm i parashkrimit i paraparë me nenin 352 të LMD-së, në të cilën përcaktohet *“Kërkesat parashkruhen për pesë (5) vjet, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit”*.

Gjykata i ka pasur parasysh dhe të njëjtën kohë i ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë konform nenit 450 lidhur me nenin 463 par.1 të LPK-së, pasi që pala e paditur nuk i ka kërkuar ato.

Nga të lartcekurat dhe bazuar në nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:031470, 06.11.2024

B. Profesional

Ali Kosova

Gjyqtari ,

Agron Karatash

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, pas marrjes së të njëjtës, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.